



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Kuvendi i Komunës Klinë

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

01Nr 06-7789 /25

Klinë, dt: 19.03 /25

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e parë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur më2025, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 16:00.

Mbledhjen e udhëhoqi Nënkyetarja e komunës së Klinës, znj. Marqe Tanushi-Selmanaj, e cila përshëndeti të gjithë anëtarët e KKSB-së dhe prezantoi rendin e ditës dhe planin vjetor për vitin 2025.

RENDI I DITËS

- 1. Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në territorin e Komunës së Klinës;**
- 2. Ushtrimi i kontrollit më të shpeshtë të trafikut rrugor për të zvogëluar aksidentet me fatalitet;**
- 3. Organizimi i trajnimit për mbrojtje nga zjarri me nxënësit e shkollave;**
- 4. Trajtimi i qenve endacakë;**
- 5. Të ndryshme.**

Nënkryetarja theksoi se prezantimi i planit për vitin 2025 ka qenë pothuajse i njëjtë me atë të vitit 2024 për arsye se, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme e kemi miratuar një plan global për të gjithë Kosovën dhe jemi dakorduar që të vazhdojmë me plan të njëjtë. Temat e sigurisë në bashkësi janë të implementuara në çdo komunë, po ashtu edhe në komunën tonë. Për vitin 2025, sigurisht që do të kemi gjashtë takime të rregullta, dhe ky këshill është i rregulluar sipas Udhëzimit Administrativ 27/2, dhe është për këshillat për siguri në bashkësi. Vizioni i këtij këshilli është të sigurojë një mjedisi të sigurt ku të gjithë qytetarët ndihen të mbrojtur dhe të sigurt dhe të bashkëpunojnë për sigurimin e mbrojtjes në përgjithësi.

Pika 1. Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në territorin e Komunës së Klinës.

Fjalën e mori përfaqësuesi nga Stacioni Policor i Klinës, z. **Skender Morina**, Shef i Operativës në Stacionin Policor të Klinës.

Ai tha se vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në Komunën e Klinës, përveç incidentit të fundit, është në nivel të kënaqshëm. Incidenti i fundit, që ndodhi pranë QTA-së, ishte një vrasje ose tentativë vrasjeje, ku përfshihej një konflikt mes disa personave nga Komuna e Klinës, që çoi në plagosje me lëndime të rënda trupore. Pas intervenimit mjekësor, gjendja e të lënduarit është përmirësuar fatmirësisht.

Ai po ashtu theksoi se incidente të tjera madhore nuk ka pasur. Në fillim të vitit, ka ndodhur një incident në komunitetin serb, ku është djegur një qytetar serb në fshatin Grabc. Toger Morina nënvizoi se gjatë këtij viti janë realizuar kontrollime të shumta për sigurimin dhe parandalimin e rasteve të krimeve, veçanërisht për parandalimin e përdorimit të armëve të zjarrit.

Në shumicën e rasteve, personat e pajisur me armë janë të autorizuar me leje të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe kanë të drejtë t'i mbajnë ato. Si pasojë, edhe dy vrasjet e fundit janë kryer me armë të legalizuara (me leje).

Statistikat për muajin janar janë si më poshtë:

58 raste gjithsej, prej të cilave:

36 vepra penale

28 aksidente trafiku

7 aksidente me lëndime

19 persona të lënduar

633 tiketa për kundërvajtje

17 persona të arrestuar, prej të cilëve **6** me masë ndalimi të vendosur nga prokurori i gjykatës

Vjedhje: **2**

Vjedhje të rënda: **6**

Dhunë në familje: **4**

Patrullime me automjete: 138

Sipas vlerësimit, gjendja e sigurisë është e mirë dhe stabile.

Pika 2. Ushtrimi i kontrollit më të shpeshtë të trafikut rrugor për të zvogëluar aksidentet me fatalitet.

Nënkryetarja e komunës shpalosi pikën e dytë të rendit të ditës, duke e elaboruar në detaje.

Pastaj fjalën e mori **Togeri, Skender Morina**, i cili u ndal te patrullimi dhe kontrollet e shpeshta të trafikut, ku tha se Stacioni Policor ka 82 policë dhe 118 staf civil dhe zyrtarë të tjerë policor. Ai theksoi se për këta policë, përshkrimi i kundërvajtjeve në Komunën tonë është në maksimum.

Pas tij, fjalën e mori **Hoxha, Fitim Bojaj**, i cili falënderoi togerin për informacionet e përgjithshme dhe bëri një pyetje në lidhje me dy vrasjet e fundit: A ka ndonjë kriter për dhënien e lejeve të armëve? A mund të jetë çështje posedimi armësh, duke pasur parasysh se kushdo mund të aplikojë për leje?

Togeri tha se është e vërtetë që dy rastet kanë ndodhur me armë të legalizuara (me leje), dhe se këto leje lëshohen nga Ministria e Punëve të Brendshme. Ai shtoi se nuk kemi as kompetencë, as fuqi për ta ndaluar këtë proces.

Pika 3. Organizimi i trajnimit për mbrojtje nga zjarri me nxënësit e shkollave.

Nënkryetarja vazhdoi me pikën e tretë të rendit të ditës, duke e shqyrtuar atë në përgjithësi.

Pastaj, fjalën e mori përfaqësuesi i zjarrfikësve, **Elmi Morina**, i cili tha se si njësi zjarrfikëse, ne ushtrojmë të rinjtë vetëm me tre zjarrfikës. Çdo javë, ne realizojmë vizita nëpër shkolla për trajnimin e nxënësve në rast rreziku nga zjarri.

Drejtori i Arsimit, z. Qemajl Sejdiu, mori fjalën dhe tha se kjo është një temë e qëlluar, ku ne si Drejtori, në përgjithësi jemi të gatshëm të bashkëpunojmë. Ai theksoi se duhet t'i përgatisim dhe trajnojmë nxënësit në rast të ndonjë fatkeqësie të zjarrit, por, fatkeqësisht shkollat në përgjithësi nuk i plotësojnë këto kritere, p.sh. shkallët emergjente në rast të zjarrit nuk ekzistojnë. Disa shkolla kanë vetëm disa mjete të kufizuara për shuarjen e zjarrit.

Më pas, fjalën e mori **Pastori, Jeton Sokoli**, i cili shprehu mbështetje për trajnimin dhe vetëdijesimin e nxënësve për shuarjen e zjarrit. Ai theksoi se, pas këtyre trajnimeve, është e nevojshme që të ketë diçka konkrete nga dikasteret e arsimit dhe të zjarrfikësve, për t'u siguruar që temat të trajtohen në mënyrë të duhur dhe konkrete.

Në vazhdim, fjalën e mori **Josip Deda**, i cili bëri një pyetje: Shkolla në Grabanicë, e cila është ndërtuar një vit më parë, pse nuk ka shkallë emergjente? A do të ketë dikush përgjegjësi që shkollat nuk i kanë këto shkallë emergjente?

Drejtori i Arsimit mori fjalën dhe tha se Komuna ka përgjegjësi, pasi që kur është bërë projekti i ndërtimit të shkollës, nuk është parashikuar ndërtimi i shkallëve emergjente. Ai shtoi se ministria gjithashtu nuk ka ndërhyrë për të ndaluar ndërtimin e shkollës pa përfshirë shkallët emergjente, por që në të ardhmen, do të bëhet kërkesë për montimin e shkallëve emergjente në atë shkollë dhe në shkolla të tjera.

Pika 4. Trajtimi i qenve endacakë.

Nënkryetarja shpalosi pikën e katërt të rendit të ditës, duke shqyrtuar dhe prezantuar shqetësimin për qentë endacakë.

Fjalën e mori **Hoxha**, i cili pyeti: A ka ndonjë masë parandalimi ose menaxhimi për të mos lejuar që qentë të enden nëpër rrugë? Po në rast se ndonjë qytetar sulmohet, kush është përgjegjës për këtë?

Fjalën e mori **Togeri**, i cili tha se nuk mund t'i drejtohen askujt përderisa nuk ka ndonjë pronar të caktuar për këta qen, dhe për më tepër, nuk mund të asgjësohen. Ai theksoi se gjatë periudhës së fundit, 5 persona janë lënduar nga qentë endacakë.

Nënkryetarja shprehu shqetësimin e saj, duke thënë se kjo është një temë që po bëhet gjithmonë më e pranishme dhe është shumë e shqetësuar pasi qentë endacakë janë të pranishëm në çdo cep të rrugës. Ajo theksoi se trajtimi i vetëm që mund të bëhet është vaksinimi i tyre, por që nuk ka asnjë vend për strehimin e tyre, dhe ata duhet të kthehen sërish në rrugë. Nënkryetarja shtoi se është një shqetësim që çdo herë na bie në diskutim dhe është e rëndësishme që këto tema të diskutohen në Këshillin për Siguri në Bashkësi.

Pas kësaj, fjalën e mori **Don Jeton Thaqi**, i cili pyeti: A ka masa për ata që braktisin qentë e tyre? A ka masa ligjore për këtë?

Togeri tha se, nëse qeni nuk ka pasaportë, nuk mund t'i drejtohen askujt. Ai shtoi se, po të ishte ashtu, ne do ta dënonim pronarin e qenit.

Pika 5. Të ndryshme.

Nënkryetarja shpalosi pikën e pestë të rendit të ditës.

Drejtori i Arsimit diskutoi dhe e pa të arsyeshme të pyesë togerin nëse ka mundësi për të realizuar kontrolle nëpër rrugë, në autobusët e nxënësve dhe nëpër shkolla, edhe pa paralajmërim.

Togeri u përgjigj se ne kemi patrulla dhe jemi një shtet demokratik, jo ushtarak. Ai theksoi se është e ndaluar me ligj që të realizohen kontrolle pa paralajmërim, përfshirë bastisjen e lokaleve. Ai shtoi se për çdo bastisje të mundshme, ne kemi nevojë për leje nga gjykata, dhe se është e ndaluar me ligj të veprojmë pa paralajmërim.

Nënkryetarja e mbylli mbledhjen e KKSB-së, me një falënderim për të pranishmit.

Procesmbajtësja,

Vjosa Gjetaj



Zv. KRYESUESJA,
znj. Marqe Tanushi- Selmanaj

